

**VENDIM**

**Nr. 186, dt. 25.09.2015**

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 25.09.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit për resturimin dhe konsolidimin vetëm të pjesëve ekzistuese në objektin “Ujësjellësi i Vranishtit”, Vranisht, Himarë.
2. Bashkia Himarë, të marrë masa teknike për sigurimin e qëndrueshmërisë së tubacioneve të vaditjes, që janë të shtrira mbi monumentin “Ujësjellësi i Vranishtit”, në mënyrë që të lejtësohet ngarkesa mbi monument.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**

